

REPUBLIKA E SHQIPERISE



BASHKIA KRUJE
KESHILLI BASHKISE

Nr _____ Prot

Kruje, me ____ / ____ / 2017

VENDIM

Nr. 152 date 15.12.2017

**“Per miratimin mbi vleresimin e demeve ne orendi dhe paisje te familjeve te
Z. Bardhok Lata dhe Z. Bashkim Prushi”**

Keshilli i Bashkise, ne mbledhjen e tij te dates 15.12.2017, pas shqyrtimit te relacionit te paraqitur nga Bashkia Kruje ,ne mbeshtetje te ligjit nr 139/2015”Per vetqeverisjen vendore”, ligjit nr. 8756 date 26.3.2001 “Per Emergjerncat Civile”, I ndryshuar, VKM nr 329 date 16.05.2012 “ Per krieteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera”, i ndryshuar, Udhezimit te perbashket te Ministrise se Brendshme dhe Ministrise se Financave nr.263 date 25.04.2013 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shtetore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore”, process-verbalit te konstatimeve te demeve te shkaktuara, shkresen e Keshillit te Qarkut mbi vleresimet e eksperteve per demet ne orendi, paisje dhe mobilje,

VENDOSI

1-Miratimin e vleres se orendive dhe paisjeve sipas preventivit te Keshillit te Qarkut Durres per Z. Bardhok Lata në shumën, 317.000 (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë) leke.

2-Miratimin e vleres se orendive dhe paisjeve sipas preventivit te Keshillit te Qarkut Durres per Z. Bashkim Prushi, ne shumen, 317.000 (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë .

3- Bashkia Kruje per mungese fondesh i propozon Ministrise se Puneve te Brendshme ,Drejtorise se Emergjencave Civile, dhenien e shumes prej 217.000 (dyqind e shtatëmbëdhjetë mije) leke , qe eshte diferenca ndermjet vleres se demeve ne orendi dhe paisje ne shumen 317.000 leke per Z. Bardhok Lata dhe ndihmes financiare te dhene me Vendimin e Keshillit te Bashkise Kruje , ne shumen 100.000 (njqind mije) leke.

4-Bashkia Kruje per mungese fondesh i propozon Ministrise se Puneve te Brendshme, Drejtorise se Emergjencave Civile, dhenien e shumes prej 217.000 (dyqind e shtatëmbëdhjetë mije) leke , qe eshte diferenca ndermjet vleres se demeve ne orendi dhe paisje ne shumen 317.000 (treqind e shtatëmbëdhjetë mijë) leke per Z. Bashkim Prushi dhe ndihmes financiare te dhene me Vendimin e Keshillit te Bashkise Kruje , ne shumen 100.000 (njqind mije) leke.

5- Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile.

6-Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI

Hysni CACA

